



SHOQATA DENTARE SHQIPTARE

Date 24/11/2015

LENDË: KOMENTE RRETH PROJEKTLIGJIT “PER NDRYSHIMET NE LIGJIN NR. 7703, DATE 11/05/1993, PER SIGURIMET SHOQERORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”

DREJTUAR:

KUVENDIT TE SHQIPERISE

MINISTRISE SE SHENDETESISE

MINISTRISE SE FINANCAVE

KOMISIONIT PER CESHTJET LIGJORE, ADMINISTRATEN PUBLIKE DHE TE DREJTAT E NJERIUT

KOMISIONIT PER PUNEN, CESHTJET SOCIALE DHE SHENDETESINE

KOMISIONIT TE EKONOMISE DHE FINANCAVE

Të nderuar zotërinj,

Se pari na lejoni te shprehim vleresimin dhe mbështetjen tone si Shoqate për reformat e rëndësishme që po ndermerrni ne sektore dhe ne fusha te ndryshme për te siguruar nje zhvillim ekonomik te qendrueshem te vendit. Ne kete kuader ne vleresojme si paresore dhe vitale iniciativat legjislative qe synojne vendosjen e rregullave sistemike qe do siguronin nje funksionim transparent dhe ligjor te sektorit stomatologjik bazuar mbi parimet e transparences se nje tregu kompetitiv imunitar ndaj deformimeve dhe mungeses se standarteve.

Shoqata jone ka ne themel te veprimtarise dhe misionit te saj garantimin dhe mirefunksionimin e te drejtave dhe interesave te stomatologeve ne nivel kombetar permes mekanizmave ligjore te parapare ne ligj . Ky mision i yni nuk mund te konsiderohet i permbushur nese sherbimi stomatologjik i ofruar nuk i pergjigjet standarteve bashkekohore dhe pritshmerive ne rritje te publikut ndaj ketij sherbimi. Kjo kerkon domosdoshmerisht, permbushjen e kriterëve te duhura per ushtrimin e profesionit te stomatologut rregulluar me ligj, investim te panderprere dhe te konsiderueshem ne kualifikimin profesional te stomatologeve brenda dhe jashte vendit permes nje edukimi vazhdues dhe pjesemarrje ne programet perkatese certifikuese apo vleresuese , investim infrastrukturor ne ambjentet klinike, ne lende te pare dhe pajisje dhe kjo gjithmone ne permbushje ne nje nivel sa me te larte te sherbimit ndaj nevojave dhe pritshmerive te popullates.

Pare ne optiken e mesiperme, ne si shoqate do te mireprisnim cdo iniciative ligjore qe do te avanconte me tej standartet e sherbimit ne kete sektor, qe do te forconte rolin rregullator qe strukturat shtetore duhet te luajne ne lehtesimin dhe eliminimin e barrierave qe pengojne arrijten e prioriteteve te tilla apo qe do te cimentonte pozicionin dhe rolin dominues qe ky sektor luan ne shendetin e pergjithshem publik.

Fatkeqesisht po ndjekim me shqetesim te madh iniciativen me te fundit ligjore te ndermarre ne lidhje me miratimin e projektligjit per ndryshimet ne ligjin nr.7703, date 11.5.1993, "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqipërisë", ku behet shtesa e meposhtme :

“Neni 1

Pas paragrafit të katërt, të nenit 9, “Llojet e kontributeve për t’u paguar”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje: “Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes të kontributeve si dhe kriteret e përcaktimit të saj, deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Projektligjin, per arsytet qe do ti elaborojme me poshte ,ne si shoqate e vleresojme ne cenim te hapur te parametrave te sherbimit stomatologjik , ne dem afat gjate te standarteve te ketij sherbimi dhe per rrjedhoje edhe te interesit te popullates. Në relacionin perkates qeveria argumenton se statusi ekonomik i profesioneve të lira nuk mund të barazohet me të vetë-punësuarit e tjerë. Pervec se ky vleresim shpreh nje mosnjohje te plote te realitetit te funksionimit dhe operimit aktual te sektorit te stomatologjise , ky trajtim i diferencuar parimisht krijon shtrembërim në kontribute mes një të vetëpunësuarit dhe një të punësuarit, që merr një pagë të caktuar për ushtrimin e profesionit si i punësuar në një subjekt tatimor.

Pavaresisht racionalitetit te mesiperme, ne gjykimin tone jane arsye dhe motive te tjera qe ne thelb e perceptojme kete ndryshim legjislativ si te paargumentuar, te pambeshtetur ligjerisht, joeficient dhe teper virtual ne zbatimin e tij praktik.

I Arsyet qe lidhen me menyren e funksionimit dhe impaktit te sherbimit stomatologjik

1.1 Sherbimi stomatologjik permes ketij ndryshimi legjislativ trajtohet thjesht si biznes apo problem ekonomik, duke lene ne hije plotesisht aspektin social dhe shendetesor te tij. Ai kryen nje sherbim me impakt te padiskutueshem mbi shendetin e njerezve, pasi nga ky sherbim perfitojne mbi 90% e popullsisë . Per rrjedhoje lypset qe te krijohen te gjitha premiset qe ky sherbim te kryeje normalisht aktivitetin e tij ne menyre qe te gjitha shtresat e popullsisë te kene akses ne kete sherbim dhe te respektohet parimi kushtetues sipas te cilit te gjithe shtetasit kane te drejte te marrin sherbim shendetesor te barabarte. Ndryshimi legjislativ i propozuar i frenon keto premisa.

1.2 Projekt ligji i propozuar rrafshon te gjitha dallimet endemike qe ekzistojne ne vete sektorin stomatologjik ne termat e pervojës, shkalles e kualifikimit, investimi i meparshem dhe i vazhdueshem vendi i ushtrimit aktivitetit etj. Sipas projektit te propozuar duhet qe te gjithe , pavaresisht aktivitetit dhe mundesive ekonomike te ndryshme te paguajne duke ju referuar pages maksimale. Nderkohe qe nese marrim si shembull nje klinike stomatologjike e kualifikuar si biznes i vogel, per vitin 2015

realizon ardhura nen 2 milion, apriori klasifikohen si punonjes me page maksimale pa marre ne konsiderate te ardhurat reale te kesaj klinike. Per rrjedhoje nuk mund te merret si reference paga maksimale pa vleresuar fillimisht xhiron e nje kabineti dentar. Kjo pagese mund te jete reference per drejtuesin teknik ne rastin e nje klinike dentare me disa mjeke te punesuar dhe shume sherbime por ne asnje rast ne nje kabinet te vogel me te vetepunesuar.

1.3 Stomatologet shesin sherbimin e tyre, por qe lenden e pare e blejne ne tregun perendimor, me cmime perndimore dhe sherbimi jepet me cmime shqiptare , pra te perballueshme nga pacientet tane. Kjo diference rendon direkt mbi stomatologet. Shumica e aktiviteteve te stomatologeve kryhen ne lokale me qera, te cilat per shkak te performances jane cilesore e me qera te larte. Paisjet dhe aparaturat qe ato blejne dhe rinovojne jane me mijera Euro dhe kryesisht merren ne tregun perendimor, pra me tarifat e tyre, pasi dihet qe ky eshte nje nga profesionetme te kushtueshem. Po ashtu armata e specialisteve ben perpjekje te medha per kualifikimin e metejshem dhe edukimin ne vazhdim, ndjek konferenca e aktiviteve edhe jashte vendit e blen literature dhe te gjitha keto rendojne direkt mbi biznesin . Per rrjedhoje tarifa te tjera shtese pervec se vendosin biznesin ne kushtet e mbijetesesesis nxisin ne fund te dites falimentimin e tij.

II Pasojat rezultuese nese projekt ligji miratohet

2.1 *Shtesa e pageses për kontributet, do të sillte perkeqësim akoma më të madh të gjendjes dhe mbylljen te një numri te konsiderueshem kabinetesh dentare.* Mbyllja do te shoqerohej me rritje te papunesise dhe nje efekt social per individin, familjen dhe shoqerine. Nga ana tjeter kjo do te sillte nje ndeshkim te pamerituar per nje kategori individesh te cilet kane investuar per shkollim brenda dhe jashte vendit.

2.2 Eshte e pritshme qe do te ulet cilesia e sherbimit stomatologjik , pasi kabinetet duke dashur te ulin shpenzimet do te tentojne te blejne materiale me te lira e jo cilesore. Nga ana tjeter kjo do te dekurajonte investimin ne material cilesie dhe teknologji te re. Sigurisht ne situata te tilla lulezohen sharlatanet e te paafet per pasoje do te kete tendenca per mbi mjekime e sherbime te stimuluar etj.

Pra sherbimi stomatologjik peson nje demtim te pariparueshem.

2.3 Eshte e pritshme qe do te shkurtohen vende pune , pasi per te ulur shpenzimet do te hiqen punonjes. Kjo do te ishte nje dem i madh per te ardhmen afatgjate te sherbimit dhe per mjeket e rinj qe jo te gjitha e kane mundesine qe te hapin aktivitet te tyre dhe jane punesuar prane disa klinikave te kolegeve me te vjeter ku startojne edhe fillesat e kualifikimit te tyre. Ne nje analize krahasuese deshrojme te theksojme se jo me larg por ne Maqedoni, per punesimin e nje punonjesi te ri shteti subvencionon 3000 Euro dhe po ashtu 3 vitet e para i paguan vete siguracionet per te. Keshtu behet ortak me biznesin per punesimine te rinjeve.

2.4 Eshte e pritshme qe do te kete edhe rritje te menjehershme te cmimeve per sherbimin stomatologjik per te perballuar kete rritje te re te shpenzimeve, cmime te cilat edhe keshtu jane jo te perballueshme per xhepat e te gjitha shqiptareve edhe pse jane shpesh 10 apo 15 here me te ulta se cmimet ne vendet perndimore per te njejtin mall dhe sherbim qe ne ofrojme. Pamundesia reale e qytetarit per te perballuar koston e sherbimit do te sillte ulje te aksesit te sherbimit dhe rritje te

prevalences se semundshmerise dhe te individeve pa dhembe ne goje. Kjo eshte nje kosto per individin dhe shoqerine.

Në këto kushte, ekziston rreziku real që jo vetëm të demotivohet ushtrimi i profesionit te stomatologut por edhe të deformohet iniciativa e lirë dhe rezultatet e ushtrimit të kësaj veprimtarie në krahasim me fusha të tjera te të bërit biznes në vendin tonë.

III Ndryshimi i propozuar ne ligj bie ndesh me standartet ligjore kushtetuese

3.1 Projektligji i propozuar eshte ne kundërshtim me nenin 11, paragrafi 3 të Kushtetutës së Shqipërisë :

Neni 11 i Kushtetutes

“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

Shoqata vlereson se projekt ligji i propozuar nderhyn ne menyre te papershtatshme dhe me mjetet joproportionale me qellimin qe kerkon te arrije. Per rrjedhoje liria e veprimtarise ekonomike ne terma te prekshem dhe faktike ne sektorin stomatologjik kufizohet konsiderueshem duke ndikuar ndjeshem ne perspektiven e ushtrimit te kesaj veprimtarie. Nga ana tjetër kjo nderhyrje ligjore nuk perligj asnje interes publik per arsyet qe elaboruam edhe me lart. Perkundrazi interesi publik do te ishte me i mbrojtur dhe me i perfaqesuar nese ky projekt ligj nuk do te kthehej ne ligj pasi keshtu do te mbrohej integriteti i sherbimit stomatologjik si dhe interesi i shoqerise.

3.2 Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar, ai cënon standartin kushtetues - parimin e sigurisë juridik. Shteti i së drejtës, i cili garantohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme të shtetit demokratik, dhe një nga elementët themelore të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike. Gjykata Kushtetuese përmes një praktike të konsoliduar është shprehur për domosdoshmërinë e zbatimit efektiv të saj, duke qenë se ky parim siguron qëndrueshmëri, parashikueshmëri, paanshmëri, etj. Parimi i sigurisë juridike është i rëndësishëm jo vetëm për individët në veçanti, por edhe për komunitetin e përfshirë në veprimtari tregtare dhe profesionet e lira. Gjykata Kushtetuese përmes vendimit nr 36 date 15.10.2007."parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre.”

Ky parim njihet nga shumë akte ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria dhe është përcaktuar si një nga parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Europian nga Gjykata Europiane e Drejtësisë. Parimi i Sigurisë Juridike efektive trajtohet dhe kërkohet të zbatohet nga shtetet anëtare të KiE-s edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është e zbatueshme edhe për profesionet e lira për ato të drejta që janë të aplikueshme për personat fizike, juridikë tregtarë. Duhet kuptuar që zbatimi i sigurisë juridike efektive është i domosdoshëm jo vetëm pasi siguria

juridike është një parim kushtetues dhe detyrim në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria, por edhe pasi, pas më shumë se njëzet vitesh postdiktaturë, siguria juridike efektive është një test i rëndësishëm për vlerësimin e funksionimit të shtetit të së drejtës.

Ata që dëshirojnë të bëjnë investime në vend kanë nevojë të sigurohen se mund të kenë pritshmëritë legjitime të sigurisë juridike, se janë në gjendje të parashikojnë në mënyrë të arsyeshme pasojat ligjore që ndikojnë në investimet e tyre dhe është një ceshtje e gjithpranuar dhe një fakt publik që sektori stomatologjik ka investuar aq shumë sa do të ishte plotësisht jolegjitime rifillimi i një investimi të tillë nga niveli zero .

Per sa me sipër ne besojmë se letra jonë do të shihet me profesionalizëm dhe realizëm dhe nisur nga bashkëpunimi i suksesshëm që kemi patur deri tani, shpresojmë që argumentat do të merren në konsideratë. Nga ana tjetër ne si Shoqata ne cilesine e grupit te interesit per projekt ligjin e propozuar , kemi pritshmerine qe perfaqesuesit tane te thirren ne mbledhjet e komisionit parlamentar per diskutimet rreth projekt ligjit si nje kerkese e domosdoshme per procesin legjislativ .

Ne kerkojme perfundimisht mosmiratimin e ketij projektligji.

Mbetemi në pritje të reflektimit tuaj ndaj letrës sonë.

Me respekt

Shoqata Dentare Shqiptare.

Kryetari

Prof. Asc. Dorjan Hysi

Sekretari i Pergjithshem. Dr. Manola Kelmendi

Anetaret e Kryesise

Prof. Asc. Etleva Droboniku

Dr. Ilir Lako

Prof. Asc. Çeljana Toti

Dr. Eno Gace

Prof. Asc. Besnik Gavazi

Dr. Ardian Ferro

Prof. Lindita Rusi

Dr. Sokol Manjani

Prof. Fejzi Keraj

Dr. Arber Cerekja

Prof. Asc. Nazmi Koçi

Dr. Grej Malo

Dr. Arjana Malltezi

Dr. Enida Petro